



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:002955

Datë: 19.11.2021

Numri i dokumentit: 02453032

**P.23/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtare ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit N.B., për shkak të veprave penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale Shmangja nga tatimi nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1937-10/19, të datës 09.01.2020, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 01.11.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini dhe të pandehurit, ndërsa me dt. 02.11.2021, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datën 19.11.2021, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** N.B., nga i ati S., e ëma S., e gjinisë N., i lindur me dt.... në Ferizaj, me vendbanim në fshatin ... K. Ferizaj, me numër personal ..., analfabet, i martuar baba i katër fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

**I.**

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 29.10.2014, në Ferizaj, me dashje ka lëshuar një numër të madh të dokumenteve të rrejshme, ku paraqitja e dokumenteve të vërteta kërkohet me ligj dhe atë në atë mënyrë që i pandehuri si pronar i firmës N.N.P “... “ me numër të regjistrimit të biznesit ..., ka lëshuar dyqind e tetëdhjetë e dy (282) faktura me transaksion fiktiv në emër të firmës “...” SH.P.K me nr. të biznesit ..., me pronar K.S. në vlerë prej 95462,37 €, andaj nga lëshimi i këtyre faturave të rrejshme i pandehuri ka përfituar shumën e parave prej dy mijë ( 2000 ) euro, të cilat ia ka marrë nga pronari i “...” SH.P.K – K.S.

me këtë ka kryer veprën penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 41, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 365, 453, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e,

## G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 €, (dyqind euro), dënimi me burg nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda afatit prej 1 /një / viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet, ndërsa dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 46 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

**Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe në emër kompensimin të Viktimave të Krimit**

**shumën prej 30 € /tridhjetë euro/, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.**

## **II.**

**Ndërsa në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-ës,**

### **REFUZOHET AKUZA**

Se me datë 29.10.2014, në Ferizaj me qëllim të shmangieve së pagesës së detyrimeve tatimore të përcaktuara me ligj, nuk i përfshinë të dhënat lidhur me ardhurat e tij, duke shmangur pagesën e tatimit, në atë mënyrë që i pandehuri si pronar i firmës N.N.P "...", me numër të biznesit ..., ka lëshuar fatura me transaksione fiktive-fatura të rrejshme në emër të firmës "... SH.P.K me nr. të biznesit ..., me pronar K.S. në vlerë prej 95462,37 €, ku si pasojë e kësaj ka bërë shmangie të pagesave detyrimeve tatimore të përcaktuara me ligj, në vlerë prej 2269,21 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë ero e njëzet e një cent ) euro.

Meqë prokurori i shtetit, në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga akuza, për veprën penale Shmangia e tatimit nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1937-10/19, e dt.09.10.2020, ka ngarkuar të pandehurin për veprat penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par. 2 dhe vepre penale Shmangia e tatimit nga neni 313 par, 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra

penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar publik me datë 01.11.2021, në të cilën prokurori i shtetit, lexoj dispozitivin e parë të aktakuzës e cila të pandehurin e ngarkon për veprën penale Dokumentet e rrejshmë lidhur me tatimin nga neni 314 par. 2 KPPRK-së, ndërsa sa i përket dispozitivit të dytë të aktakuzës i cili të pandehurin e ngarkon për veprën penale Shmangja nga tatimi nga neni 313 par1 të KPPRK-së, prokurori i shtetit theksoi se për shkak se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes tërhiqem nga ndjekja penale për këtë veprën penale. Gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar dispozitivin e parë të aktakuzës dhe atë të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga dispozitiv i dytë i aktakuzës, konform nenit 246 par. 4 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm për dispozitivin e parë të aktakuzës.

**I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se:** e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës për të gjitha pikat e saj, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj gabime, gjendjen ekonomike e kam jo të mirë dhe në njëfarë mënyre kjo më shtyrë që të kryej këtë lloj vepre penale dhe për këtë lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

**Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se:** pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që një pranim i tillë është bërë konform dispozitave e nenit 248 të KPPK-së, duke u mbështetur në fakte e prova të cilat i përmban aktakuza dhe i propozoj gjykatës të bëjë pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion të paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit si: Raporti final hetues i dt. 16.10.2019 i Drejtorisë për Hetime Tatimore dhe Inteligjencës së ATK-së, Detajet e vlerësimit nga ATK-ja në formë të tabelare lidhur me deklarinimin dhe pagesat e biznesit i N.N.P.”...” i dt. 07.02.2019, Faturat fiktive përgjatë viteve 2013-2014 të

biznesit N.N.P. "...", Gjendja e përgjithshme e tatimpaguesit, deklarimet dhe pagesat pranë ATK-së, Faturat nga tatim paguesit e firmave tjera që ndërlidhen me biznesit e N.N.P. "...” deklarata e të pandehurit e dhënë prokurori me dt. 12.12.2019, si dhe provat tjera që gjenden në shkesat të lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par.2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese përkatësisht që në shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e dobët ekonomike, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë kesi lloj vepre penale apo të ngjashme, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në

parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.23/2020, e datës 19.11.2021**

**Zyrtare Ligjore**  
**Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.